

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. ELBASAN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Elbasan, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 4, datë 07.01.2015.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.200, me shkresën nr. 885/24, datë 08.01.2015 dërguar Z. Altin Cenolli, Drejtor i Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Elbasan, dhe Këshillit Mbikqyrës, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i zbatimit dhe realizimit të rekomandimeve të KLSH-së nga auditimi i mëparshëm, u konstatua se nga 33 masa organizative të rekomanduara, 14 prej tyre janë realizuar, 8 janë realizuar pjesërisht dhe 11 nuk janë realizuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat rezultuan ende të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme rekomandimet të cilat janë në procese gjyqësore, trajtuar më hollësisht në faqet 27-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

2. Shoqëria “Elber” shpk, nuk ka bërë rregullisht trajnimin e anëtarëve të njësisë së prokurimit të paktën njëherë në vit, për çështjet e prokurimit publik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë për të trajnuar anëtarët e njësisë së prokurimit të paktën njëherë në vit, për çështjet e prokurimit publik, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, trajtuar më hollësisht në faqet 118-177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

3. Nga auditimi i procedurave të prokurimit kanë rezultuar mangësi që kanë të bëjnë me skualifikim operatorësh me arsyetimin e mosparaqitjes së ofertës, ndërkohë që në sistemin elektronik rezulton e paraqitur, janë kualifikuar operatorë me dokumentacion më të hershëm se përcaktimet e DST, është s'kualifikuar për mungesë dokumentacioni një operator ekonomik, ndërkohë që në procedurën e dytë është kualifikuar me të njëjtin dokumentacion, KVO nuk kishte në përbërje specialistë të fushës, specifikimet teknike të mallit të lëvruar ndryshonin me ato në kontratë, kushtet e përgjithshme të kontratës nuk janë të nënshkruara në të gjitha fletët nga titullari i autoritetit kontraktor, titullari i autoritetit kontraktor, nuk ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim, operatorët ekonomikë fitues i kanë sjellë dokumentet dorazi, si dhe nuk

janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Në prokurimin e fondeve, të zhvillohen procedurat e prokurimit “Tender i hapur”, dhe në rastet e përdorimit të procedurave të tjera, kryesisht “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit”, të bëhet vetëm mbi bazën me një argumentimi ligjor për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure, trajtuar më hollësisht në faqet 118-177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

-Autoriteti Kontraktor, të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike, trajtuar më hollësisht në faqet 118-177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

-Ti kushtohet vëmendja e nevojshme institucionale nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë ose zëvendësuesi i tagrave të tij, shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt, trajtuar më hollësisht në faqet 118-177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

4. Pavarësisht se më datën 31.08.2014 është lidhur marrëveshja ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), për kalimin e shoqërisë “Elber” shpk Elbasan në shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime sh.a Elbasan, sipas shkresës nr. 225 datë 23.06.2014 të (MZHETS), por nuk është përcaktuar mënyra e kalimit (me likuidim, transferim aksionesh etj), të pasurisë të ish-shoqërisë “Elber” shpk. Deri në datën 15/11/2014, datë që ka përfunduar auditimi, nuk kanë filluar akoma procedurat e kalimit, pasi nga ana e MZHETS, nuk ka dalë asnjë udhëzim për mënyrën e kalimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të marrë masa për përcaktimin e mënyrës së kalimit (me likuidim, transferim aksionesh, etj) të pasurisë të ish-shoqërisë “Elber” shpk Elbasan në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a. Elbasan, trajtuar më hollësisht në faqet 42-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

5. Nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe kërkesat e Kodit të Punës, duke i harmonizuar ato me Kontratën Kolektive të Punës dhe aktet e tjera të shoqërisë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Elbasan, të marrin masa që për nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të zbatojnë kërkesat e ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe kërkesat e Kodit të Punës, duke i harmonizuar ato me Kontratën Kolektive të Punës dhe aktet e tjera të shoqërisë, trajtuar më hollësisht në faqet 60-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

6. Nga ana e Shoqërisë “Elber” sh.p.k. Elbasan nuk janë përfshirë ndryshimet që i janë bërë rregullores së brendshme me nr. 1621 prot., datë 12.11.2013 për implementimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe treguesit e Performancës.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” sh.a Elbasan, të merren masat për implementimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe treguesit e Performancës, në zbatim të pikës 1, neni 20 dhe pikës 2, neni 21, të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, trajtuar më hollësisht në faqet 87-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

7. Megjithëse humbjet tekniko-ekonomike të ujit të cila për këtë shoqëri janë një ndër problemet kyç me ndikim të fuqishëm në gjendjen e përgjithshme ekonomiko-financiare të shoqërisë, nuk janë marrë masat e nevojshme për analizën periodike dhe përcaktimin e masave të domosdoshme për kapërcimin e situatës, duke bërë përcaktimin e detyrave e objektivave për të ardhmen.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Asambleja e Aksionarëve dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojnë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe të marrin masat e nevojshme për të mundësuar drejtimin e shoqërisë, drejt rezultateve pozitive, trajtuar më hollësisht në faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

-Drejtoria e shoqërisë, të bëjë një analizë të hollësishme të kostove operative për të identifikuar mundësitë, për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve, si dhe të uljes së çmimit për m³ të ujit të prodhuar dhe të shitur, trajtuar më hollësisht në faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

-Nga Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” sh.a. Elbasan për vitin 2015, të bëhet bilanci i ujit (analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike (menaxhariale). Në programin ekonomik të vitit pasardhës, humbjet të parashikohen të detajuar në humbje teknike dhe ekonomike (manaxhariale), trajtuar më hollësisht në faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 31.03.2015

-Të merren masa konkrete për evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve, duke koordinuar punën me sektorët përkatës, për debitorët që nuk likuoidojnë detyrimet përkatëse të operohet në zbatim të Ligjit nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, trajtuar më hollësisht në faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

-Të merren masa për rritjen e transparencës ndaj klientëve, në lidhje me ankesat që kanë për mbi faturimet, verifikim të matësit të ujit etj, duke i trajtuar konform dispozitave ligjore për ankesat, trajtuar më hollësisht në faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

-Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” sh.a. Elbasan, të bëjë një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk janë të pajisur me matës, duke synuar që brenda vitit 2015, të bëhet

pajisja 100 për qind e tyre, trajtuar më hollësisht në faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 31.12.2015

8. Nga auditimi rezultoi se për vitin 2012, nuk ka dalë asnjë urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë për kryerjen e inventarizimit të pasurisë së shoqërisë, ndërsa për vitin 2013 dhe 2014, kanë dalë urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, por nga ana e komisioneve të ngritura, nuk janë kryer inventarizimet për pasurinë e shoqërisë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a Elbasan, të marr masa për kryerjen e inventarizimit të Aktive Afat Gjata Materiale, trajtuar më hollësisht në faqet 83-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a. Elbasan, të analizohet dhe të dal përgjegjësia për mos kryerjen e inventarizimeve nga komisionet e ngritura për këtë qëllim, si dhe të merren masat disiplinore përkatëse, trajtuar më hollësisht në faqet 83-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 31.12.2015

9. Nga ana e Drejtorisë Ekonomike për periudhën e audituar, janë kryer pagesa nëpërmjet arkës në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3, germa “e” dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 64.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a. Elbasan, që për arkëtimet dhe pagesat e kryera nëpërmjet arkës, të zbatohet Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, trajtuar më hollësisht në faqet 87-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

10. Për periudhën e audituar, Departamentet e Shoqërisë në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, nuk kanë hartuar dhe dërguar për miratim në Asambleshën e Aksionarit, programin ekonomik-financiar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, të miratojnë programin ekonomik-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, dhe nëse është parashikuar në statut dhe ligjet specifike, të miratohet edhe nga Aksioneri i vetëm, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë e Sipërmarrjes, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar, trajtuar më hollësisht në faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

11. Shoqëria “Elber” sh.p.k. nuk ka miratuar pasqyrat financiare të viteve ushtrimore 2012 dhe 2013 në Asambleshën e Aksionarit, për sa i përket realizimit të ardhurave, shpenzimeve materiale, fitimit, gjendjes së debitorëve, realizimin e investimeve etj, në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës, Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a. dhe Departamenti i Financës, të marrin masa për miratimin e pasqyrave financiare në Asamblenë e Aksionarit, për realizimin e treguesve sipas programit ekonomik të zhvillimit, për realizimin e investimeve, të fitimit si dhe për çdo tregues tjetër që i shërben njohjes së situatës ekonomiko financiare të shoqërisë, trajtuar më hollësisht në faqet 47-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

12. Ka munguar bashkërendimi i punës midis departamenteve, për të programuar saktë nevojat për prokurimet me vlera të vogla për punë, mallra dhe shërbime, nuk janë përcaktuar grup mallrat e shërbimeve sipas natyrës së përdorimit, për të shmangur copëzimin e fondeve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit me efektivitet, transparencë dhe konkurrencë të operatorëve ekonomikë.

Blerjet me vlera të vogla janë kryer duke mos mbajtur parasysh regjistrin e prokurimeve me vlera të vogla, duke mos respektuar limitin ligjor të blerjeve për grup apo artikuj prej 400 mijë lekë, pasi ky limit është tejkaluar sipas grupeve të mallrave apo artikujve për 5.192.205 lekë, dhe për pasojë duhet të zhvilloheshin procedurat përkatëse për prokurimin e tyre, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VI, pika 2, germa “a”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2012, “Për blerjet me vlera të vogla” i ndryshuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe Departamentet përkatëse të marrin masa, që procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”, të bëhen vetëm mbi bazën e një argumentimi ligjor për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure, si dhe të ndjekjes në vazhdimësi të realizimit të regjistrit të prokurimit me vlera të vogla, trajtuar më hollësisht në faqet 118-177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

13. Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë në bashkëpunim me departamentet, nuk kanë kryer analizë të hollësishme mbi gjendjen e debitorëve, nuk ka ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit ndaj subjekteve debitore, nuk i është paraqitur për analizë të mëtejshme Këshilli Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Aksionarit, në kundërshtim me ligjin nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Asambleja e Aksionarëve dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë gjendjen debitore dhe kreditore të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” sh.a. Elbasan më datë 31.12.2014, si dhe të marrin masa të nevojshme për reduktimin e tyre.

Brenda 31.03.2015

14. Drejtorja dhe departamentet e shoqërisë, nuk kanë bashkërenduar punën midis tyre për arritjen e objektivave të përcaktuara në programet e zhvillimit të shoqërisë, nëpërmjet rritjes së efikasitetit të zbatimit të ligjit, nëpërmjet kontrolleve të përbashkëta e krijimit të hapësirave të nevojshme sipas ligjit për kontrollin e brendshëm.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë të marrë masa për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011, "Mbi përgatitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike", trajtuar më hollësisht në faqet 177-181, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 31.03.2015

15. Për periudhën objekt auditimi, është shpenzuar karburant për mjetet e shoqërisë në sasinë 60,000 litra me vlerë 10,269,352 lekë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit (gjatë auditimit dhe me observacione), nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, pasi një pjesë e dokumentacionit justifikues bazë është me mangësi. Konkretisht nuk ka fletë-udhëtime, urdhër punë, aktet teknike për përcaktimin e normativës së harximit të karburantit për çdo automjet, si dhe kartelat përkatëse të tyre, rakordime mujore dhe vjetore për sasinë e naftës së tërhequr nga magazina me harxhimin në fakt të sasisë së tërhequr për çdo drejtues mjeti etj. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", SKK 2 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare", duke i krijuar në këtë mënyrë një efekt financiar negativ në vlerën 10,269,352 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Mbikëqyrës, Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Elbasan, të shqyrtohet efekti financiar negativ për vlerën 10,269,352 lekë, për të cilin nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar", trajtuar më hollësisht në faqet 87-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.03.2015

16. Për periudhën e audituar, u konstatua se janë paguar 3 punonjës me vlerë 42,272 lekë, jashtë strukturës e organikës së shoqërisë, me profesione si mjek, jurist, kur në të njetën kohë nga ana e kësaj shoqërie është plotësuar organika me jurist, në kundërshtim me shkresën e aksionarit të vetëm të shoqërisë METE me nr. 4568/1 prot. datë 29.02.2012 "Miratim i Programit Ekonomik të shoqërisë për vitin 2012", ku ka bërë dhe miratimin e tabelës së pagave për vitin 2012, pika 14.

Për sa më sipër rekomandojmë:

- Të shqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës tejkalimi i strukturës organizative me 3 punonjës me vlerë 42,272 lekë, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, për dëmshpërblim në zbatim të nenit nenin 31 dhe 32 "Përgjegjësia e personit juridik" të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, trajtuar më hollësisht në faqet 60-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Brenda datës 31.03.2015

17. Për vitin 2013, kjo shoqëri është ndëshkuar me gjoba në vlerën 269 mijë lekët, të cilat kanë të bëjnë me gjoba nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe organet tatimore, si dhe gjoba në 10 raste në vlerën 57.100 lekë, cilat kanë të bëjnë me gjoba nga Drejtoria e Shfrytëzimit të Automjeteve, si pasojë e mos kryerjes në afatin e caktuar të pagimit të taksave dhe kontrollit

teknik të automjeteve, si dhe gjoba nga policia e qarkullimit rrugor, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Kreu III, neni 18, pika 1.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Elbasan, të shqyrtohet efekti financiar negativ për vlerën 269 mijë lekë, që përfaqëson gjoba e kamat vonesa të vendosura nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe organet tatimore, si dhe gjoba në 10 raste në vlerën 57.100 lekë, cilat kanë të bëjnë me gjoba nga Drejtoria e Shfrytëzimit të Automjeteve, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, në zbatim të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, trajtuar më hollësisht në faqet 87-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

18. Janë kryer pagesa për blerje për bileta udhëtimi jashtë vendit në vlerën 827.216 lekë pa kryer asnjë procedurë prokurimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit fq.).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Elbasan, të shqyrtohet vlera 827.216 lekë, që përfaqëson blerje me vlera të vogla, për bileta udhëtimi jashtë vendit, pa kryer asnjë procedurë prokurimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës ndaj komisionit të blerjeve me vlera të vogla, në zbatim të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, trajtuar më hollësisht në faqet 87-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.03.2015

19. Në 59 raste me vlefte 639,120 lekë janë krye pagesa nëpërmjet arkës për blerje me vlera të vogla, pa dokumentacionin e plotë justifikues. Konkretisht blerjet nuk janë shoqëruar me kuponin tatimor, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, neni 54, pika 1 dhe neni 55 pika 1.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Elbasan, të shqyrtohet vlera 639,120 lekë, që përfaqëson blerje me vlera të vogla, krye me pagesa nëpërmjet arkës, pa dokumentacionin e plotë justifikues. Konkretisht blerjet nuk janë shoqëruar me kuponin tatimor, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, neni 54, pika 1 e neni 55 pika 1, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, ndaj komisionit të blerjeve me vlera të vogla, në zbatim të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, trajtuar më hollësisht në faqet 118-177, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.03.2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Në 113 raste për vlerën 112.455 lekë janë kryer pagesa të tepërta të punonjësve, si pasojë përlllogaritjeve të gabuara të tatimit mbi të ardhurat, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **112.455 lekë**, si përfitim i padrejtë në paga, në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 9, pika 1. Në mënyrë të detajuar Aneksit nr. 1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, trajtuar më hollësisht në faqet 60-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 30.06.2015

2. Në vitin 2012, nga ish-Drejtori i Përgjithshëm të shoqërisë “Elber” sh.p.k. Elbasan [REDAKTUAR], janë bërë ndryshime në paga në kundërshtim me pozicionin e punës, për pasojë është përfituar tepër pagë nga punonjësit në vlerën 2,544.000 lekë, në kundërshtim me miratimin që ka bërë aksionari i vetëm METE me shkresën nr. 4568/1, datë 29.02.2012 “Miratim i programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2012”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **2.544.000 lekë** si përfitim i padrejtë page , në kundërshtim me miratimin që ka bërë aksionari i vetëm METE me shkresën nr. 4568/1, datë 29.02.2012 “Miratim i programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2012”. Në mënyrë të detajuar Aneksit nr. 2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, trajtuar më hollësisht në faqet 60-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 30.06.2015

3. Në vitin 2013, nga ish-Drejtori i Përgjithshëm të shoqërisë “Elber” sh.p.k. [REDAKTUAR], janë bërë ndryshime në paga në kundërshtim me pozicionin e punës, për pasojë është përfituar tepër pagë nga punonjësit në vlerën **123.000 lekë**, në kundërshtim me miratimin që ka bërë aksionari i vetëm METE me shkresën nr. 4568/1, datë 29.02.2012 “Miratim i programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2012”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 123.000 lekë, si përfitim i padrejtë page, në kundërshtim me miratimin që ka bërë aksionari i vetëm METE me shkresën nr. 4568/1, datë 29.02.2012 “Miratim i programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2012”. Në mënyrë të detajuar Aneksit nr. 3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, trajtuar më hollësisht në faqet 60-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 30.06.2015

4. Në vitin 2012, nga ish-Drejtori i Përgjithshëm të shoqërisë “Elber” shpk Elbasan [REDAKTUAR], janë bërë ndryshime në paga në kundërshtim me pozicionin e punës, për pasojë është përfituar tepër pagë nga punonjësit në vlerën 278.500 lekë, në kundërshtim me miratimin që ka bërë aksionari i vetëm METE me shkresën nr. 4568/1, datë 29.02.2012 “Miratim i programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2012”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **278.500** lekë, si përfitim i padrejtë page, në kundërshtim me miratimin që ka bërë aksionari i vetëm METE me shkresën nr. 4568/1, datë 29.02.2012 “Miratim i programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2012”. Në mënyrë të detajuar Aneksit nr. 4, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, trajtuar më hollësisht në faqet 60-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 30.06.2015

5. Në vitin 2013, nga Drejtori i Përgjithshëm të shoqërisë “Elber” sh.p.k.. Elbasan [REDAKTUAR], janë bërë ndryshime në paga në kundërshtim me pozicionin e punës, për pasojë është përfituar tepër pagë nga punonjësit në vlerën 298.000 lekë, në kundërshtim me miratimin që ka bërë aksionari i vetëm METE me shkresën nr. 4568/1, datë 29.02.2012 “Miratim i programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2012”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **298.000** lekë, si përfitim i padrejtë page, në kundërshtim me miratimin që ka bërë aksionari i vetëm METE me shkresën nr. 4568/1, datë 29.02.2012 “Miratim i programit ekonomik të shoqërisë për vitin 2012”. Në mënyrë të detajuar Aneksit nr. 5, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, trajtuar më hollësisht në faqet 60-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 30.06.2015

6. Në muajin Korrik 2012, në 7 raste me vlerën 46.926 lekë janë paguar tepër orë jashtë kohës normale të punës për punonjësit, në kundërshtim me VKM nr. 511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar, neni 5.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **46.926** lekë, si përfitim padrejtësisht page për orë jashtë kohës normale të punës, në kundërshtim me VKM nr. 511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar, neni 5. Në mënyrë të detajuar Aneksit nr. 6, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, trajtuar më hollësisht në faqet 60-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 30.06.2015

7. Në vitin 2012, nga ish-Drejtori i Përgjithshëm të shoqërisë “Elber” sh.p.k. Elbasan [REDAKTUAR], është lidhur kontratë me Andi Grykshi si jurist i jashtëm, i cili ka përfituar pagë më tepër në vlerën 20.272 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar, neni 5.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 20.272 lekë, nga Andi Grykshi si përfitim padrejtësisht page, në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar, neni 5, trajtuar më hollësisht në faqet 60-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 30.06.2015

8. Në vitin 2012, nga ish-Drejtori i Përgjithshëm të shoqërisë “Elber” sh.p.k. Elbasan [REDACTED], është lidhur kontratë me [REDACTED] si mjeke e jashtme, e cila ka përfituar pagë më tepër në vlerën 20.000 lekë, në kundërshtim me VKM nr.511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar, neni 5.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 20.000 lekë, nga [REDACTED] si përfitim padrejtësisht page, në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar, neni 5, trajtuar më hollësisht në faqet 60-66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda 30.06.2015

9. Në vitin 2012, nga ish-Drejtori i Përgjithshëm të shoqërisë “Elber” shpk Elbasan [REDACTED], është lidhur kontratë me [REDACTED] si jurist i jashtëm, i cili ka përfituar pagë më tepër në vlerën 2.000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar, neni 5.

